



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN  
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

**TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:  
DREJTIMI MËSIMOR “NDËRTIM”**

**Janar, 2015**

## 1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të drejtimit “Ndërtim”, me strukturë 2+1+1, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testimeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programet orientuese për Provimet Përfundimtare në: drejtimin “Ndërtim”, Niveli I; në profilin “Shtrim dhe veshje me pllaka”, Niveli II, “Karpenteri, hekurkthim dhe betonim”, Niveli II, “Muratim dhe suvatim”, Niveli II dhe profilin “Punime dhe riparim rrugësh”, Niveli II;
- programet e lëndëve teorike profesionale të drejtimit “Ndërtim”, Niveli III (klasa e 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr.61, datë 10.02.2015.”.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve. Për Bazat e sipërmarrjes, janë marë parasysh vetëm njohuritë e reja dhe jo veprimtaritë praktike.

## 2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale të integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për drejtimin mësimor “**Ndërtim**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

### 3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të “**Teorisë profesionale të integruar**” në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar”, të Maturës Shtetërore Profesionale, për drejtimin mësimor “**Ndërtim**”, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtme:

1. Materiale ndërtimi, kl. 10.
2. Teknikë ndërtimi, kl. 10.
3. Teknikë ndërtimi, kl. 11.
4. Konstruksione ndërtimi, kl. 11.
5. Bazat e sipërmarrjes, kl. 13.
6. Ligjshmëria dhe organizimi në ndërtim, kl. 13.
7. Teknikë ndërtimi me elemente projekti, kl. 13.
8. Konstruksione ndërtimi me elemente projekti, kl. 13.
9. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13.

**Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues**

| Nr | Lënda                                 | Vëllimi i orëve për çdo lëndë | Peshat në % |
|----|---------------------------------------|-------------------------------|-------------|
| 1  | Materiale ndërtimi                    | 14                            | 5           |
| 2  | Teknikë ndërtimi                      | 86                            | 28          |
| 3  | Konstruksione ndërtimi                | 46                            | 15          |
| 4  | Bazat e sipërmarrjes                  | 19                            | 6           |
| 5  | Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm   | 14                            | 5           |
| 6  | Ligjshmëria dhe organizimi në ndërtim | 34                            | 11          |
| 7  | Teknikë ndërtimi me elemente projekti | 48                            | 16          |
| 8  | Konstruksione ndërtimi me elemente    | 44                            | 14          |

|  |               |            |             |
|--|---------------|------------|-------------|
|  | projekti      |            |             |
|  | <b>TOTALI</b> | <b>305</b> | <b>100%</b> |

**Temat sipas lëndëve janë:**

- a. **Materiale ndërtimi, kl. 10:** **(14 orë)**
- Vetitë kryesore të materialeve të ndërtimit 4 orë
  - Materialet lidhëse joorganike (allçi, çimento) 4 orë
  - Betonet dhe elementet prej beton-armeje të parapërgatitura 4 orë
  - Llaçet e ndërtimit 2 orë
- b. **Teknikë ndërtimi, kl.10 dhe kl.11:** **(86 orë)**
- Themelet 10 orë
  - Muret 10 orë
  - Ndërkatet 6 orë
  - Shkallët 6 orë
  - Çatitë 12 orë
  - Mbulesat 10 orë
  - Tarracat 12 orë
  - Punime rifiniture 20 orë
- c. **Konstruksione ndërtimi, kl. 11:** **(46 orë)**
- Kuptimet bazë të statikës 4 orë
  - Sistemi i çfarëdoshëm i forcave plane dhe kushtet e ekuilibrit të tyre 4 orë
  - Përkulja e trarëve të drejtë 8 orë
  - Trarët e vazhduar 2 orë
  - Njohuri për betonin dhe rezistencat e tij 4 orë
  - Njohuri për armaturën e hekurit dhe përpunimi i saj 4 orë
  - Bazat e konstruktimit të elementeve beton arme: pllakat, trarët, shkallët, shtyllat, plintat 20 orë
- d. **Bazat e sipërmarrjes, kl. 12 dhe kl. 13:** **(19 orë)**
- Tregu dhe sjellja konsumatore 5 orë
  - Legjislacioni i punës 5 orë
  - Menaxhimi i informacionit 4 orë
  - Menaxhimi i marketingut 5 orë

- e. **Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13:** **(14 orë)**
- Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor 3 orë
  - Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis 3 orë
  - Zhvillimet demografike dhe mjedisi 4 orë
  - Shoqëria e konsumit dhe mbetjet 4 orë
- f. **Ligjshmëria dhe organizimi në ndërtim, kl.13:** **(34 orë)**
- Njohuri për ligjet urbanistike dhe lejet për ndërtimin e objekteve 4 orë
  - Njohuri për organizimin e punës 4 orë
  - Njohuri për ligjshmërinë në ndërtim për marrëdhëniet sipërmarrës-investitor-supervizor-nënkontraktor 4 orë
  - Njohuri për rregullat e sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit në punimet e ndërtimit 4 orë
  - Planorganizimi i punimeve dhe elementet përbërëse të tij 6 orë
  - Dokumentimi teknik i punimeve të ndërtimit 6 orë
  - Dokumentimi teknik për përfundimin e punimeve të ndërtimit 6 orë
- g. **Teknikë ndërtimi me elemente projekti, kl.13:** **(48 orë)**
- Njohuri për urbanistikën, pjesët përbërëse funksionale të saj dhe elementet e projektit 2 orë
  - Interpretimi i projektit urbanistik të bllokut të banimit 2 orë
  - Njohuri për ndërtesat qytetare dhe pjesët përbërëse funksionale të tyre me elemente projekti arkitektonik 6 orë
  - Interpretimi i projekteve të ndërtesave të banimit dhe shoqërore-kulturore 10 orë
  - Njohuri për ndërtesat bujqësore e industriale dhe pjesët përbërëse funksionale të tyre me elemente projekti arkitektonik 6 orë
  - Interpretimi i projekteve të ndërtesave bujqësore dhe industriale 2 orë
  - Njohuri për rrugët, urat, veprat e artit dhe elementet përbërëse të tyre me elemente projekti 8 orë
  - Interpretimi i projekteve të rrugëve, urave e veprave të artit 2 orë
  - Njohuri për veprat hidroteknike dhe elementet përbërëse të tyre me elemente projekti 8 orë
  - Interpretimi i projekteve të veprave hidroteknike 2 orë
- i. **Konstruksione ndërtimi me elemente projekti, kl.13:** **(44 orë)**
- Njehsimi i ngarkesave dhe gjatësive njehsuese të elementeve përbërëse të konstruksionit mbajtës prej betoni të armuar 4 orë
  - Njohuri për skemat konstruktive të ndërkateve dhe shkallëve prej betoni të armuar 6 orë
  - Njehsimi dhe konstruktimi i ndërkateve monolite prej betoni të armuar me pllaka dhe trarë 10 orë
  - Njehsimi dhe konstruktimi i ndërkateve të përzier prej betoni të armuar

- (me mbushje tulle të lehtësuar) 4 orë
- Njehsimi dhe konstruktimi i mureve dhe shtyllave prej betoni të armuar 4 orë
  - Njohuri për bazamentet 4 orë
  - Njehsimi dhe konstruktimi i themeleve të veçuar (plintave) prej betoni të armuar 4 orë
  - Njehsimi dhe konstruktimi i mureve prej guri e tulle 4 orë
  - Njehsimi dhe konstruktimi i themeleve të vazhduara prej betoni, butobetoni e guri 4 orë